




REPUBLIKA E KOSOVËS



INSPEKTORATI
QENDROR I PUNËS



Komuna e Mitrovicës së Jugut

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI NDËRMJET:

INSPEKTORATIT QËNDROR TË PUNËS(IQP-së)
DHE
KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

KORRIK, 2025



Në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe me qëllim të forcimit të sundimit të ligjit, sigurisë dhe shëndetit në punë dhe transparencës institucionale, palët e nënshkruara:

Komuna e Mitrovicës, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, z. Bedri Hamza, dhe Inspektorati Qendror i Punës, i përfaqësuar nga z. Rizah Plakolli UD- Drejtor Ekzekutiv,

shprehin vullnetin e përbashkët për bashkëpunim institucional dhe bien dakord për nënshkrimin e këtij Memorandumi Bashkëpunimi, në përputhje me pikat dhe kushte si vijon:

Neni 1

Qëllimi i Memorandumit

Qëllimi i këtij memorandumi është të krijohet një mekanizëm efikas bashkëpunimi dhe shkëmbimi informacioni ndërmjet Komunës së Mitrovicës dhe Inspektoratit Qendror të Punës, për të siguruar:

1. Informimin e rregullt të Inspektoratit të Punës për të gjitha lejet e ndërtimit të lëshuara nga Komuna.
2. Planifikimin dhe realizimin e përbashkët të inspektimeve në terren për projektet ndërtimore.
3. Parandalimin e punës së padeklaruar dhe shkeljeve të tjera të legjislacionit të punës dhe sigurisë në vendin e punës.

Neni 2

Shkëmbimi i Informacionit

1. **Komuna e Mitrovicës** do të përcjellë çdo muaj, në formë elektronike dhe të standardizuar, një listë të detajuar të lejeve të ndërtimit të lëshuara, që përmban informacionin si vijon:
 - o Emri i investitorit;
 - o Lokacioni i ndërtimit;
 - o Data e fillimit të projektit (nëse është e specifikuar);
 - o Lloji dhe madhësia e objektit;
 - o Përshkrimi i projektit ndërtimor (nëse është i disponueshëm).
2. Ky informacion do të mundësojë Inspektoratit Qendror të Punës përpunimin efikas të të dhënave dhe realizimin e inspektimeve të nevojshme.

Neni 3

Bashkëpunimi në Inspektime

1. Palët do të organizojnë takime të rregullta për koordinimin e aktiviteteve të inspektimit, veçanërisht për inspektimet në objektet e ndërtimit.
2. Komuna do të njoftojë Inspektoratin Qendror të Punës për çdo projekt ndërtimor që mund të paraqesë rrezik për punë të padeklaruar ose kushte të pasigurta pune.
3. Inspektorati Qendror i Punës do të angazhojë inspektorët e saj për të monitoruar zbatimin e legjislacionit të punës, përfshirë Ligjin e Punës dhe Ligjin për Siguri dhe Shëndet në Punë, në projektet ndërtimore të raportuara.



Neni 4

Zbatimi dhe Monitorimi

1. Palët do të caktojnë pika kontakti për zbatimin dhe mbikëqyrjen e këtij Memorandumi Bashkëpunimi.
2. Palët do të hartojnë një raport vjetor për të monitoruar dhe vlerësuar efektivitetin e bashkëpunimit, duke përfshirë aktivitetet dhe rezultatet e arritura. Ky raport do të ndihmojë në përmirësimin e mëtejshëm të proceseve dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Neni 5

Kohëzgjatja dhe Ndryshimet

1. Ky Memorandum hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit nga të dyja palët dhe ka një periudhë zbatimi prej **tre (3) vjetësh**, me mundësi vazhdimi automatik nëse palët bien dakord për vazhdimin e bashkëpunimit.
2. Çdo ndryshim në përmbajtjen e këtij memorandumi mund të bëhet vetëm me marrëveshje të shkruar ndërmjet palëve.

Ky Memorandum është nënshkruar dhe ratifikuar në Mitrovicë më date. 31.07.2025, në dy (2) kopje të barabarta, nga palët e përfaqësuara.

Për Komunën e Mitrovicës,

Kryetar i Komunës



Për Inspektoratin Qendror të Punës

Rizah Plakolli



ED- Drejtor Ekzekutiv
Inspektorati Qendror i Punës

